

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit B. (A.) H. nga P. rruga "...", për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.6368/2018 të dt.27.11.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur në praninë e prokurorit të shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të pandehurit dhe të dëmtuarit, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më datën 28.01.2019 gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **B.H.**, nga i ati A., nëna A., e vajzërisë Sh., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në rrugën "...", P., me numër personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomiko sociale, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Më datë 29.10.2018, rreth orës 16:00, në rrugën "...", në P., i pandehuri për shkak të një mosmarrëveshje lidhur me disa punime të cilat kohë më parë i kishte kryer në shtëpinë e të dëmtuarit, i njëjti, e ka goditur 4-5 herë me thikë në kokë të dëmtuarin H.Rr., mjetë ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore,

- Më këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 42,43, 45 dhe 73 si dhe nenit 188 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, i shqipton këtë:

**DËNIM ME BURG**

Të pandehurin **B.H.**, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 **(tre) muajsh**, të cilin dënim do ta vuaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjyimi të merr formën e prerë.

**Detyrohet** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **20.00 Euro**, (për ekspertizën mjeko-ligjore), kurse në emër të shpenzimeve paushallë gjyqësor të paguaj shumën prej **20 Euro**, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**Detyrohet** i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të paguajë shumën prej **30 euro**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari H. Rr. me vendbanim në rrugën "...", në P., për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.6368/2018 të dt.27.11.2018, ka akuzuar të pandehurin B.(A.) H. nga P., rruga "...", për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.28.01.2019, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i pandehuri B.H. dhe i dëmtuari H.Rr.

I pandehuri B.H., në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranojë fajësinë, i kërkoj falje të dëmtuarit, më vjen keq që ka ndodhur ky rast, unë i premtoj gjykatës se ky rast nuk do të përsëritet asnjëherë, tek familja e të dëmtuarit kemi dërguar njerëzit sipas traditave, dhe ende nuk jemi rregulluar tërësisht.

I dëmtuari H.Rr. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se do të paraqesë kërkesën pasurore juridike në kontest civil, ndërsa gjykata do të vendos sipas ligjit kurse me të pandehurin ende nuk jemi rregulluar.

Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit u bë me vullnetin e tij të plotë pa kurrfarë presioni dhe konform dispozitave ligjore të KPRK-së, andaj i propozoi gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e analizoi dhe vlerësoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në mendimin dhe konstatimin e Ekspertizës mjekoligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr.N.U., të dt.26.11.2018, të dhënë me shkrim lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve ku është konstatuar se i dëmtuari H.Rr., ka pësuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale

Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjyqimit, ndjen shumë keqardhje për rastin dhe për veprimet e tij për të cilët edhe i kërkon falje gjykatës dhe të dëmtuarit për lëndimet dhe përjetimet e pësuar, premtimin se do të jetë më i kujdesshëm në të ardhmen dhe nuk do të kryej veprë penale, i pa punë, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike vlera e mbrojtur është integriteti i njeriut. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjyqimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor është marrë, konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 të KPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil, është marrë, në bazë të nenit 463 par.2 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**P.nr.757/2018 më dt.28.01.2019**

**Gjyqtari:**  
Minir Hoti

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.